



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1105/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada - Gllogjani kryesuese, Milena Đerić dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosjes (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së shtandit- shtëpi të drurit me materiale zgjedhore në rrugë publike për qëllime elektorale, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 11.11.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**I. PRANOHEN** të bazuara ankesat e evidentuara me numra Anr.1105/2021 dhe Anr.1106/2021 të datës 08.11.2021, paraqitur nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, ashtu që subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV), me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimi më gjobë në shumë prej 2,100.00 (dymijë e njëqind) euro për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike - për shkak të vendosjes së materiale zgjedhore në shtande - shtëpi të drurit në rrugë publike për qëllime elektorale.

**II. DETYROHET** Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë që gjobën e shqiptuar si në pikën –I- të dispozitivit të këtij vendimi ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendimi nën **kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë**.

### A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar ankesat Anr.1105/2021 dhe Anr.1106/2021 të datës 08.11.2021 nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës në të cilat pretendon se me datë 08.11.2021 rreth orës 12:00 kanë vërejtur se aktivistët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje që kanë vendosur material zgjedhor përfshirë e shtande - shtëpi të drurit me materiale zgjedhore me numër të subjektit politik për këto zgjedhje-144 dhe emrin e kandidatit për kryetar komune Arben Vitia si dhe llogon e Partisë nga ku kanë shpërndarë edhe material zgjedhor në tri lokacione si sheshi “Nëna Terezë”, te Bulevardi “Bill Klinton” në lagjen Dardania dhe amfiteatrin e sheshit “Zahir Pajaziti”. Parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur fotografi të printuara.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se ky veprim është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes dhe janë sanksionuara me dispozitën ligjore të nenit 33 pika b) të LZP-së,

dispozita të zbatueshme në kuptim të nenit 15 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

PZAP, me datë 08.11.2021, i ka dërguar kërkesë për përgjigje Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje duke i kërkuar që të përgjigjet deri me datë 09.11.2021, në ora 12:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 09.11.2021 subjekti politik LVV e kundërshton pretendimin e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës duke theksuar se me datë 08.11.2021 Lëvizja Vetëvendosje përkatësisht Kandidati për kryetar komune të Prishtinës, Arben Vitia nga ora 12:00-14:00 në sheshin “Zahir Pajaziti” dhe “Nëna Terezë ka bërë prezantimin e programit përmes fotografive duke përfshirë harta të ndryshme ku ka paraqitur zotimet e tij në rast se zgjedhet kryetar i komunës. Për mbajtjen e këtij prezantimi LVV është e pajisur me leje përkatëse nga organi kompetent i komunës se Prishtinës duke theksuar se bashkangjitur ankesës kanë dërguar provën për lejen nga komuna. Më tutje kanë theksuar se LVV e njofton Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës se shtandi në formë të shtëpisë se drurit të vendosura në sheshet e lartcekura janë vendosur sipas pëlqimit të lëshuar nga Drejtoria për Shërbime publike Mbrojtje dhe Shpëtim i Komunës se Prishtinës për periudhën 27.10.2021-07.11.20219 (periudhë e cila nuk konsiderohet fushat zgjedhore). Pra banerat si në fotot e bashkangjitura në ankesë janë larguar nga shtëpitë e drurit me datë 07.11.2021 kur edhe ka përfunduar afati si në pëlqimin e lëshuar nga Drejtoria përkatëse e Komunës. Si provë krahas përgjigjes në ankesë ka bashkangjitur fotografit nga vendi i ngjarjes.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

#### **Ankesat janë të bazuara**

Paneli, pas vlerësimit të pretendimeve në ankesat Anr.1105/2021 dhe Anr.1106/21 të datës 08.11.2021, të cilat për nga përmbajtja janë të njëjta dhe të gjitha ankesat janë paraqitur nga subjekti politik LDK, po ashtu të njëjtat janë paraqitur kundër subjektit të njëjtë politik Lëvizja Vetëvendosje, prandaj Paneli, bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”*, bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli nga fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se shtandi me material zgjedhor të subjektit politik LVV është i vendosura në hapësirat – rrugët publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) e LZP-së, e cila përcakton *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe postereve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve”*.

Parashtrimet në përgjigje në ankesë, se veprimet e subjektit politik LVV për vendosjen e këtyre shtandeve, është bërë me pëlqimin e Komunës së Prishtinës - Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, të datës 27.10.2021 deri me 07.11.2021, Paneli pretendimet e tilla i vlerësoj si të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj pasi që, me këto prova nuk justifikon veprimet që janë të ndaluara dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të Nenit 33 pika b) i LZP-së, ku parashihet se subjektet e certifikuara politike aktivitetet e tyre zgjedhore duhet t'i bëjnë në pajtueshmëri me Rregullat zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ). Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Gjithashtu PZAP, sipas detyrës zyrtare ka zhvilluar hetim, dhe nga rezultatet e hetimit ka rezultuar se Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, nuk e ka përmirësuar shkeljen e paraqitur në ankesë, pasi që shtandet me material zgjedhor të subjektit politik LVV, janë të vendosura në sheshin "Zahir Pajaziti" dhe "Nëna Terezë" edhe pse e njëjta me kërkesë për përgjigje në ankese është urdhëruar që ta ndërmarra te gjitha masat përmirësuese për evitimin e shkeljeve te pretenduara sipas ankesës, mirëpo e njëjta nuk ka vepruar ne te gjitha lokacionet për heqjen e materialeve zgjedhore, por i kishte evituar vetëm në Bulevardin Bill Clinton, në lagjen Dardania.

Paneli, vendimin e tij e ka mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, prandaj pretendimet në përgjigje në ankesë nuk u cilësuan me ndikim ndryshe në vendosjen e lëndës.

Paneli vlerësimin dhe vendosjen në raport me shkeljen e cekur me lartë e bazon në LZP-në si ligj special në raport me ligjet e tjera në të cilat mund të gjen mbështetje pëlqimi apo lejimi për shfrytëzimin e hapësirës publike (rrugë, sheshe etj). Me rastin e ekzaminimit dhe vlerësimin të secilës ankesë për shkelje te dispozitave te LZP-se që i referohet veprimeve te ndaluara të subjekteve politike apo kandidateve te pavarur, me rastin e zhvillimit te fushatës zgjedhore, vlerësimi i pretendimeve ankimore në raport me këto shkelje i referohet veprimeve te ndërmarra nga subjekti në fjalë se a janë ato veprime ne përputhje me dispozitat e LZP-së apo ato veprime a përfshihen në ndalesat e sanksionuara me ligjin ne fjalë.

Pajisja me leje për shfrytëzimin e hapësirës publike, sheshit apo çfarëdo hapësire tjetër nuk nënkupton se një leje e tillë e amnistion subjektin në fjalë nga kufizimet apo ndalesat e paraparë me dispozita të LZP-së.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalët, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin së subjekti politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i

njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marra subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë PZAP-i, mori parasysh edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësia për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tij ka mohuar shkeljet e supozuara, dhe ka ndërmarrë pjesërisht masa përmirësuese për evitim të materialeve zgjedhore në rrugë publike – sheshe dhe kjo ka pasur efekt edhe në vendosjen sa i përket lartësisë së gjobës.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.1105/2021 më datën 11.11.2021



*Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa komfor nenit 118 par 4 të LZP-së*